



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

---

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike  
Mbledhja nr. 21  
Prishtinë, më 26.4.2018, në orën 14:30  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**P r o c e s v e r b a l**

**Në mbledhje morën pjesë:** Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, dhe Zafir Berisha.

**Munguan:** Aida Dërguti dhe Sërgjan Mitroviq.

Me ftesë të Komisionit në këtë mbledhje i pranishëm ishte z. Per Strand Sjaastad, Ambasador i Norvegjisë në Kosovë dhe z. Stein-Ivar Lothe Eide, zëvendësambasador i Norvegjisë në Kosovë.

**Nga zyra e Komisionit:** Manush Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim me z. Per Strand Sjaastad, Ambasador i Norvegjisë, për të diskutuar në lidhje me vizitën e Komisionit në Norvegji;**
- 3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 29 mars, 3, 10 dhe 12 prill 2018;**
- 4. Funkcionalizimi i grupeve punuese të Komisionit;**
- 5. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

*Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.*

**2. Takim me z. Per Strand Sjaastad, Ambasador i Norvegjisë, për të diskutuar në lidhje me vizitën e Komisionit në Norvegji;**

**Vjosa Osmani-Sadriu**, pasi i uroi mirëseardhje Ambasadorit, tha se gjatë këtij takimi do të diskutohen disa çështje të cilat konsiderohet se janë të rëndësishme për t'i trajtuar gjatë takimit me komisionin homolog dhe me anëtarë të delegacioneve të Kuvendit apo Ministrisë së Punëve të

Jashtme. Kjo vizitë, tha se mund të shërbej si shembull i ndërmjetësimit të marrëdhënieve bilaterale me Norvegjinë. Ajo njoftoi se ka kontaktuar me ish- ambasadorët në Suedi, të cilët kanë mbuluar Norvegjinë, me të cilët ka biseduar për temat të cilat do t'i parashtrijmë gjatë takimeve në Oslo.

**Per Strand Sjaastad**, tha se është kënaqësi dhe nder për Norvegjinë që t'ju ftojnë si Komision që ta vizitoni Norvegjinë dhe se kjo vizitë është një manifestim i marrëdhënieve në mes të dy vendeve, të ndërtuara në 10-15 vitet e fundit. Pjesa kryesore e vizitës, tha se do të jetë vizita në "Storting" Parlamentin Norvegjez, ku Komisioni do të takohet me Komisionin për Punë të Jashtme dhe Mbrojtje, me delegacionet e Norvegjisë në organizatat e ndryshme ndërkombëtare, siç janë OSBE-ja, NATO, KE-ja si dhe me grupe të caktuara të sekretarisë së Parlamentit, ku do të shpjegohet se si funksionon parlamenti në Norvegji.

Pjesa tjetër e vizitës, tha se janë takime me aktorë tjerë në Norvegji, si me Sekretarin Shtetëror në Ministrinë e Punëve të Jashtme si dhe me aktorë tjerë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, me të cilët do të diskutohen dhe theksohen çështjet politike. Ambasadori njoftoi se gjatë kësaj vizite do të mbulohet edhe ofrimi i disa këndvështrimeve të modelit nordik, model i cili mund të jetë inspirim për Ballkanin perëndimor sa i përket bashkëpunimit me vendet e rajonit. Në pjesën e fundit të vizitës tha se do të trajtohet aspekti i paqes dhe i pajtimit dhe do të përbëhet nga ekskursione, ku do të tregohen disa gjëra që e rrethojnë Oslon dhe traditat norvegjeze. Sa i përket vizave, ato nuk përbëjnë ndonjë problem dhe se mund të rregullohet kjo çështje.

**Stein-Ivar Lothe Eide**, tha se nëse Komision dëshiron mund të organizohet një hapësirë në program, që të takohet diaspora e Kosovës në Norvegji. Sa i përket vizave, tha se procedura e rregullt për vizë është shumë e vështirë, mirëpo, ne mund të ndërmjetësojmë në aspektin e vizave për këtë vizitë.

**Vjosa Osmani Sadriu**, njoftoi se Kryesia e Kuvendit e ka lejuar këtë vizitë si dhe njoftoi për itinerarin e fluturimit dhe për hotelin e rezervuar. Sa i përket vizave, kryetarja shtoi se Komisioni i Punëve të Jashtme nuk do të duhej të kishte probleme me viza, megjithatë procedura e aplikimit për viza merr kohë. Ajo pyeti se si do të organizohet transporti i delegacioni nga aeroporti në hotel dhe gjatë takimeve.

**Per Strand Sjaastad**, sa i përket transportit, njoftoi se transporti nga aeroporti në hotel duhet të mbulohet nga Komisioni, kurse sa i përket transportit gjatë takimeve do të rregullohen nga Ambasada e Norvegjisë.

**Vjosa Osmani Sadriu**, lidhur me agjendën e datës 9 maj, ku do takohen deputetët të cilët janë në Asamblenë Parlamentare të KE-së dhe të OSBE-së, pyeti nëse ndonjë përfaqësues i delegacionit të Asamblesë Parlamentare të NATO-s mund të merr pjesë në këtë takim, pasi që edhe Kuvendi i Kosovës e ka përfaqësuesin e tij në këtë asamble.

**Per Strand Sjaastad**, lidhur me kërkesën e kryetares për t'i takuar përfaqësuesit e Norvegjisë në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, tha se do t'ia përcjell këtë kërkesë parlamentit. Ambasadori foli për politikën e jashtme të Norvegjisë, e cila është e përqendruar në 4 çështje kryesore. Çështja e parë tha se është dimensionin nordik, bashkëpunimi me vendet nordike, i cili ka qenë vendimtar gjatë historisë për shumë dekada. Çështja tjetër tha se është dimensionin euro-atlantik, i cili është i rëndësishëm si për rajonin ashtu edhe për Kosovën. Ai shtoi se Norvegjia nuk është anëtare e BE-së, mirëpo ka marrëveshje të ndryshme gjithëpërfshirëse. Si çështje të tretë të rëndësishme të politikës së jashtme të Norvegjisë, ambasadori i cilësoi marrëdhëniet e Norvegjisë me Rusinë. Lidhur me këtë njoftoi se Norvegjia duke qenë anëtare e NATO-s dhe Rusia duke qenë një kundërshtar kryesor i saj,

kjo e vendos Norvegjinë në një situatë të lajthitshme, sepse duhet të balancohet anëtarësia në klubin përëndimor dhe në të njëjtën kohë duhet të ketë marrëdhënie të mira me fqinjët. Çështja e katërt e politikës së jashtme të Norvegjisë tha se është qasja globale. Ambasadori po ashtu tha se Norvegjia ka kontribuar në shumë misione paqeruajtëse, dhe se ka besim të madh te OKB-ja për të shtyrë agjenda duke variuar nga lufta e varfërisë, mbrojtjen e mjedisit e deri tek misionet paqeruajtëse. Sa i përket Ballkanit përëndimor, njoftoi se Norvegjia është e angazhuar në këtë rajon për një kohë të gjatë, duke promovuar integrimin e Kosovës dhe shteteve fqinje në strukturat euro-atlantike.

**Vjosa Osmani Sadriu**, njoftoi se komisioni është në kontakt me Ministrinë e Punëve të Jashtme për të marr rekomandime dhe informacionet e fundit se si marrëdhëniet me Norvegjinë kanë avancuar. Ajo ngriti shqetësimin lidhur me organizimin e konferencave dhe tryezave të rrumbullakëta, të cilat mbështeten nga Ambasada e Norvegjisë dhe disa ambasada tjera, në të cilat Kuvendi lihet anash. Lidhur me këtë shprehu mendimin se në çështjet siç janë dialogu, Kuvendi duhet ta thotë fjalën e tij, sepse sa më tepër të përfshihet Kuvendi aq më tepër do të ketë mbështetje për dialogun dhe se të gjitha marrëveshjet vijnë për miratim në Kuvend.

**Per Strand Sjaastad**, tha se institucionet e krijuara në Kosovë duhet të trajtohen me seriozitet. Ai po ashtu tha se pajtohet me atë që tha kryetarja lidhur me organizimin e konferencave dhe tryezave, duke shtuar se kanë marr qëndrimin se nuk do të merren me çështjet e mikromenaxhimit. Do ta kem parasysh atë që thatë ju dhe shpresoj që do të mund të lëvizim gjërat një nga një në të ardhmen, tha në fund z. Per Strand Sjaastad.

**Dukagjin Gorani**, sa i përket vizitës, pyeti nëse mund të organizohet ndonjë takim me përfaqësuesit e Partisë Social Demokrate.

**Per Strand Sjaastad**, lidhur me kërkesën e deputetit Gorani, tha se mund të aranzhohet kjo dhe se do të mundohen ta përfshijmë këtë në agjendë.

**Vjosa Osmani Sadriu**, tha se do t'i bëjë ftesë Komisionit për Punë të Jashtme dhe Mbrojtje të Norvegjisë që ta vizitojë Kosovën. Ajo shtoi se Komisioni do të fokusohet që të diskutojë çështje të ndryshme gjatë kësaj vizite dhe kërkoi nga ambasadori që nëse ka ndonjë sugjerim ai mund ta kontaktojë komisionin.

### **3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 29 mars, 3, 10 dhe 12 prill 2018;**

*Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 29 mars, 10 dhe 12 prill 2018, ndërsa procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 3 prill 2018 mbetet të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së komisionit.*

Mbledhja përfundoi në orën 15:10.

Kryetarja e Komisionit,

\_\_\_\_\_  
Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:  
Njësia për mbështetjen e komisionit.